



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Infrastrukturës
Ministarstvo Infrastrukture
Ministry of Infrastructure

REFERENCË:			
PËR/ZA/TO/:	Z.Ramush Haradinaj, Kryeministër i Qeverisë së Kosovës		
CC:	Z.Pal Lekaj, Ministër i Ministrisë së Infrastrukturës		
NGA / OD / FROM:	Z.Rexhep Kadriu, Zëvendësministër		
TEMA / SUBJEKAT / SUBJECT:	Raporti 100-në ditor i punës (01.01.2018 - 10.04.2018)		
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	Lokacioni: Kucni: Extension:	Data: Datum: Date:	10.04.2018
PËR INFORMIMIN TUAJ / ZA VASU INFORMACIJU / FOR YOUR INFORMATION			

I nderuar, Kryeministër!

◆ Unë Rexhep Kadriu nga zyra e juaj e kryeministrit jam emëruar në pozitën e Zëvendësministrit në Ministrinë e Infrastrukturës me datë 21.11.2017.

Ditën e parë të fillimit të punës takimin e parë e kam mbajtur me Ministrin Pal Lekaj, ku nga Ministri kam marr detyrat si dhe angazhimet që duhet t'i kem në Ministrinë e Infrastrukturës e ato janë:

- a) Menagjimi i projekteve të Infrastrukturës Rrugore së bashku me këshilltarin Fatos Mani.
- b) Menagjimin e kredisë së investimeve me BERZH-in si projekte investive të kredisë (Gjilan, Klllokot, Ferizaj dhe Prizren).
- c) Menagjimi i kredisë me BERZH-in për rrugën Kiev-Zahaq ku kemi përfundur të gjitha procedurat e formimit të njësisë mbikqyrëse.
- d) Përfundimi i të gjitha procedurave për ndërtimin e Autoudhës Prishtinë-Gjilan-Konqul, ku këtë projekt e kemi gjetur të përgjysmuar dhe të tenderuar

pa procedura ligjore ku për këto muaj kemi kryer të gjitha procedurat dhe kemi filluar zyrtarisht punimet me datën 15 prill.

- e) Menagjimi dhe përfundimi i aktiviteteve në zgjerimin e rrugës Prishtinë-Mitrovicë me investim nga Fondi Saudit, ku këto ditë presim zyrtarisht të fillojnë punimet.
- f) Përfundimi i të gjitha procedurave për zgjerimin e rrugës Prishtinë-Podujevë dhe nga java e ardhshme do të fillojnë punimet zyrtarisht.
- g) Në strategjinë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe politikat e përcaktuara nga Ministri Pal Lekaj për mbështetje financiare të Komunave, më ka angazhuar në këtë detyrë që së bashku me këshilltarin Fatos Mani dhe drejtorin e financave Besnik Hajdari ti përgatisim memorandumet e mirëkuptimit me Komunitat të cilat kanë bërë kërkesë për mbështetje financiare. Ky proces është përfunduar në 95% të Komunave.
- h) Gjatë kësaj kohe në muajin e fundit jam duke punuar fuqishëm për Autostradën e Dukagjinit si dhe zgjerimin e rrugës Dollc - Gjakovë.
- i) Angazhimi im maksimal në fillimin e rrugës Deçan - Plavë e cila edhe zyrtarisht filloi para pak ditësh.

Përpos këtyre projekteve kam marr angazhime nga Ministri për t'i shtyrë edhe projektet e mbetura nga qeverisjet e kaluara dhe monitorimin e kompanive për mirëmbajtjen e rrugëve, si dhe sinjalistikën ku bashkarisht me departamentin e rrugëve si dhe këshilltarin Fatos Mani po punojmë që këto rrugë të kenë një standard më kualitativ.

Angazhimi tjetër të cilin e kam marr kohëve të fundit është monitorimi i investimeve të BERZH-it në hekurudhat e Kosovës, për arsye se ky projekt ka rreth 2 vite që ka ngecje dhe shumë shpejt do të dalim me rekomandimet tona.

Prej kohës kur kam marr mandatin, përballja më e vështirë ka qenë situata e krijuar me reshjet e shiut për 60 ditë, ku kemi pasur rrëshqitje të dheut nëpër shumë rrugë të Republikës së Kosovës si dhe në Autostradën "Ibrahim Rugova", por ajo më shqetësuesja ka qenë rrëshqitjet e disa rrugëve, ku kemi konstatuar për kualitet të dobët të ndërtimit të këtyre rrugëve në ish-qeverisjet e kaluara, ku ne si Ministri e Infrastrukturës do të përballemi me sanimin e gjendjes e cila do të ketë edhe pasoja financiare.

Detyrë tjetër e marr nga Ministri Pal Lekaj ka qenë menagjimi i situatës së Janarit dhe Shkurtit gjatë kohës së reshjeve të borës, ku personalisht në baza ditore jam marr me menagjimin e komplet situatës ku për herë të parë pas 18 viteve rrugët rajonale dhe regionale në Republikën e Kosovës kanë qenë më të pastërtat në rajon.

Angazhimi tjetër për këto muaj si Zëvendësministër i parë në Ministrinë e
Infrastrukturës janë takimet e shumta me qytetarë si dhe takimet zyrtare në mungesë
të Ministrit.

Me respekt,

Rexhep Kadriu , Zëvendësministër në Ministrinë e Infrastrukturës.